

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënimi i Hagës - Berisha: PD beson se apeli do bëjë drejtësi! Gjykata justifikoi akuzat bajate të padronit të Edi Ramës
ADRESA	https://www.syri.net/politike/917075/denimi-i-ish-krereve-te-uck-se-berisha-pd-beson-se-apeli-do-beje-drejttesi-gjykata-justifikoi-akuzat-bajate-te-padronit-te-edi-rames/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 12:10:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 12:01:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f3ebf9f3ec46b1ae7bcf5b66e7ab7fdf2e78d5854bc78490fb0df0e38150171f
TEKSTI	b74aef616ae215284186fb06d5fa874a78145eed0c2d2ad5e580ccc90e0ebad
PAMJA	4ce199f449e12a60d966d622cd03ce5935ec826a57212be183f0deec79565d6b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5a87c6edd84984900533853d4627d2ae50eef00d9d866f3fcefda3bc18f46a24
E MËPARSHMJA	5495a97bfbdb5d316983bf9b572ffdd56d88e68d98c806a6667aa69e46bcd14fb
RRËNJA MERKLE	485c8b8c8ba28305218c58e8c7791d525f1a193166e89422b0670a53018cd566
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5a87c6edd84984900533853d4627d2ae50eef00d9d866f3fcefda3bc18f46a24>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





NDRIÇIM KULLA

Gjuha si brushë dhe ironia si armë e Edi Ramës



IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



Berisha: PD beson se apeli do bëjë drejtësi! Gjykata justifikoi akuzat bajate të padronit të Edi Ramës

14:01, 16/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Lideri i PD-së u shpreh kritik ndaj vendimit të gjykatës special për 4 ish drejtuesit e UÇK-së, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi.

"Ishte si të justifikojë akuzat bajate, propagandistike të Sllobodanit dhe pasardhësit të Sllobodanit, edhe të padronit të Edi Ramës" tha Berisha duke shtuar se beson se Apeli i Gjykatës Speciale do bëjë drejtësi!

Pjesë nga fjala e Berishës

Asnjë njeri nuk merr dhe nuk mund të marrë në mbrojtje një krim të vetëm. Por të konceptosh një luftë pa spiunë, pa ndëshkim të spiunëve, 120 mijë francezë u përgjigjën para ligjit për bashkëpunimin e tyre, vend në botë që nuk dënon, që nuk ndëshkon kolaboracionistët nuk ka.

Ushtri në botë, në luftë, që nuk merr në pyetje të dyshuarit për veprimtari kundër, nuk ka.

Ishte jashtëzakonisht e papranueshme deklarimi se qëllimi... po cili ishte qëllimi i tyre, qëllimi i tyre ishte çlirimi i Kosovës, çfarë qëllimi tjetër kishin këta?

Këta çdo gjë e bënë për çlirimin e Kosovës.

Paskan pasur ndonjë qëllim personal të veçantë?!

Ajo ishte si të justifikojë akuzat bajate, propagandistike të Sllobodanit dhe pasardhësit të Sllobodanit, edhe të padronit të Edi Ramës.

PD, edhe njëherë, shpreh vlerësimin më të madh për Luftën Çlirimtare të popullit të Kosovës dhe shpreson dhe beson se apeli i gjykatës, unike në botë në llojin e saj se aty janë mbledhur të gjitha dosjet e Beogradit.

Dhe u akuzuan për transplant të organeve, zero!

Akuza të tjera. U tha se do merrej me krimet e pasluftës, e pas çlirimit të Kosovës, u mor me akte të vitit 1995, 1996, se pse vendosën të luftojnë.

Po të lexojë aty, ishte një gjë e pakonceptueshme. Aty nuk kuptojë se kush ishte shteti pushtues dhe çfarë qëndrimi duhet të mbaje në pretendë.

më të lexuarat




Zhupa: Nga shkollat me turne të emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin



Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç



'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre



Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'



Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezinë: Godina i përket Klubit Labëria, po zhdukët historia



PD: Shpopullimi i Shqipërisë, një krizë që po zbraz vendin dhe po rrezikon të ardhmen e tij



Që kur vendose, thoshe, ke bërë edhe në këtë vit. Ishte pushtim ai, çfarë kishte bërë në këtë vit? Kishte bërë kundër pushtuesit. Ndaj dhe le të shprehim ne shpresën, besimin se gjykata e apeli, se apeli do të bëjë drejtësi, do të shkëputet nga propaganda serbe.

© SYRI.net

Lexo edhe:



SHBA-ja: Respektojmë aktgjykimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së! Palët të respektojnë vendimin dhe shmangin retorikën nxitëse



Dënimi i ish krerëve UÇK, Prokurorja Speciale: S'u ndoq penalisht as UÇK-ja e as lufta për pavarësinë e Kosovës



PD ripërsërit kërkesën: Kuvendi i Shqipërisë të miratojë Rezolutë për dënimin e genocidit serb në Kosovë

Urimi dhe mesazhi i Metës: PISA janë një tjetër dëshmi e gjendjes alarmante të shkollave! Për PL-në arsimit prioritet

'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

Ngërçi me pagat/ Gjykata e Kukësit mbyll dyert për qytetarët 3 ditë

TË NGJASHME



Dënimi i ish krerëve të UÇK-së, Protestuesit gjuajnë me gurë drejt zyrave të EULEX-it



Trump ka të drejtë për NATO-n. Shqipëria duhet të bëjë detyrën e saj



Berisha: Përkrahje të plotë protestës. Zgjedhësit tuaj, duhet të jenë me ju në protestë, si qytetarë



Berisha: E vlerësoj ngritjen e komisionit për KAYO, Implikojnë Shqipërinë në kontrabandë, blen armë nga zonat e luftës



SYRI TV/ Reagon kompania ukrainase, konfirmon vërtetësinë, DEL-CNG: Regjistrimi në ambientet e kompanisë



SYRI TV/ Katër ish-krerët e UÇK-së dënohen në Hagë, Hashim Thaçi dënohet me 25 vjet burgim



Berisha: Përplasjet me sistemin e drejtësisë dëshmi se kemi një shtet bandit! Lënia pa paga, krim kushtetues

LAJME POLITIKE KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.